



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 907/ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: BOE: **Montal Sh.p.k NIPT J62009007F**, adrese: Tiranë, "Dervish Hima" 3 kullat K.3 AP 9/2, përfaqësues me prokurë të posacme i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë **Montal me NIPT J62009007F** Adresë: Tiranë, "Dervish Hima" 3 kullat K.3 AP 9/2 dhe **Biometric Albania me NIPT J61827062E** Adresë Tiranë, Rr "Vllazen Huta" Pallat i Ri Vila Park, Kati 6.

* * *

Procedura e prokurimit: e hapur, me mjete elektronike, mallra,

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-44694-02-07-2018.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"MM1-Blerje materiale konsumi me bazë tekstil dhe konsumable të përgjithshme, sisteme infuzioni - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj) "**.

Fondi limit*i marrëveshjes kuadër: **19,970 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH** ku fondi limit nënkupton totalin e çmimeve të përlogaritura për njësi për çdo artikull, referuar pikës 7.3 të Udhëzimit nr. 6, datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total): 194,282,802 lekë pa TVSH. — procedurë e hapur – me mjete elektronike - mallra.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- **ALMedikal shpk pa ofertë**
- **Bylis Pharma pa ofertë**
- **Euromed Shpk pa ofertë.**
- **Bashkimi i OE "MEDFAU" shpk, me NIPT J93610823R dhe "FEDOS" me NIPT K01514009I me përfaqësues MEDFAU shpk me ofertën me vlerë për njësi për cdo artikull 17,202.30 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e dy pikë tridhjetë) lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 164,238,715.90 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH.**
- **Bashkimi i operatoreve: Montal me NIPT J62009007F dhe Biometric Albania me NIPT J61827062E me përfaqësues Montal Shpk me ofertën me vlerë për njësi për cdo artikull 3,573.50 Leke (tremijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë)**

lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 166,137,710.50 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dhjetë pikë tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- ***ALMedikal shpk pa ofertë***
- ***Bylis Pharma pa ofertë***
- ***Euromed Shpk pa ofertë***
- ***Bashkimi i OE “MEDFAU” shpk, me NIPT J93610823R dhe “FEDOS” me NIPT K01514009I me pëfaqësues MEDFAU shpk me ofertën me vlerë për njësi për cdo artikull 17,202.30 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e dy pikë tridhjetë) lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 164,238,715.90 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH.***

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Shoqëritë ***ALMedikal shpk, Bylis Pharma Shpk, Euromed Shpk*** nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Gjithashtu keto shoqëri nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike

dhe ***BOE: OE “MEDFAU” shpk dhe “FEDOS” shpk:***

I. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, nr. 9, është përcaktuar: “*Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në e.ee.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, rrezultoi se në sistemin e prokurimeve elektronike, janë paraqitur dokumente me emërtimin Katalog dhe katalogje ku përcaktohen përmes emërimit të artikullit përkatës, nga verifikimi i të cilit konstatohet se këto dokumenta janë në gjuhë të huaj. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmblusur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”. Në nenin 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”; Në nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “*Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe*”.

Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: “*Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër*”

Katalogët e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësisht të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj.), por përmban edhe karakteristika teknike të shprehura e shpjeguara me përshkrim.

Përcaktimi i bërë në dokumentat e tenderit, si në seksionin IV, ashtu edhe në Shtojcën 9 Kriteret e vecanta të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

II. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, nr. 9,

është përcaktuar: “Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)”. Bashkimi i operatorëve ekonomik për Artikujt 3, 5, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 18, 19 dhe 21 në kategorinë “Garza, Bende, të tjera konsumable të përgjithshme” dhe artikulli 1 dhe 4 në kategorinë “Sisteme dhe doreza” nuk janë të shënuara me nr rendor, në kundërshtim me kriterin nr. 9 të KVK.

Gjithashtu për Artikujt 5, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15 në kategorinë “Garza, Bende, të tjera konsumable të përgjithshme” nuk janë të markuar, në kundërshtim me kriterin nr. 9 të KVK.

III. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik rezulton se mostrat/ artikujt e paraqitur nuk përmbushin specifikimet teknike për artikujt si më poshtë vijon,

- a. Për artikullin 17 “Hemostatik kolageni I absorbueshem” nuk plotëson specifikimet teknike, sepse nuk është me origjinë nga tendinat e kuajve por nga tendinat e gjedhve (bovine).
- b. Për artikullin 26 “Solucion pastrimi për optike” nuk plotëson specifikimet teknike, sepse nuk është me solucion pastrimi por solucion kundër mjegullës që formohet në lente. Gjithashtu as në mostra dhe as në katalog nuk përcaktohet përdorimi i këtij solucion për fibrat optike të endoskopëve.
- c. Për artikullin 1 “Sisteme Infuzioni” nuk plotëson specifikimet teknike, pasi nuk janë të shprehura në katalogun e ofruar specifikimet e kërkuara.

IV. a. Deklarata e konformitetit të leshuar nga Prodhuksi Zhejiang Kang Li Di Medical për artikullin nr. 16 “Kompresë antimikrobiale 10x10 cm” nuk është e saktë pasi nuk është e firmosur dhe nuk është shënuar data e leshimit. Gjithashtu dhe Çertifikata CE me nr. Regjistrimi DD 60042566 0001, të trupit certifikues TUV Rheiland, e përmendur në Deklaratën e Konformitetit, nga verifikimi kryer nga komisioni në faqen eeb <https://www.certipedia.com>, rezulton se kjo certifikatë CE nuk është me vlefshme.

Mostrat e dorëzuara janë të shoqëruara me listën e inventarizimit, të vëlosura.

Nga kontrolli që ju bë ofertës së dorëzuar prej saj rezulton se nuk ka gabime aritmetike.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda 5 ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.03.2018

Ankesa: ka ose jo Po

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 13.04.2018

* * *

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Merita Xhafaj